

U NDERUA AKTIVISTI DHE TRIMI I POPULLIT EGJIPTIANË KOSOVAR

TANIMË I NDJER - IBISH BAJRAMI



16.10.1952 --- 23.10.2011

Me 20.Nëntor.2011 Në Kantonin e Zürich-ut, në qytetin Bülach, në Hotelin e njohur: „ Zum Goldenen Kopf “me rastin e Tubimit Komemorativ kushtuar të ndjerit ,Ibish Bajramit, Lidhja e Egjiptianëve të Kosovës në Zvicër LEK-u, nderoi burrin dhe intelektualin e madhë të Kombit Egjiptian.



QELË KIKA – Aktivist i dalluar dhe Ish Kryetar i dytë i partis së IRDK-së dega në Zvicër

Tubimin e hapi Zt.Qel Kika ku i përshendeti pjesëmarrësit,dhe pastaj u ndëgjua *Hymni i Kosovës*, dhe u nderua Heroi i popullit Egjiptian Kosovarë Ibish Bajrami me *një minut heshtje*.

Zt. Qel Kika lexoi disa Telegramme Ngushëlluese të dërguar kryesisë së LEK-ut në Zvicër nga:

Zt.Bislim Hoti –Kryetar i Partis së LEK-ut në Gjakovë,

Zt.Sadedin Delia –Kryetar i Shoqatë Piramida në Austri

Zt.Dr.Rubin Zemon –UBE

Zt.Gazmend Dervishi – ish Nënkryetar i Partis IRDK, dhe aktivist i shquar i qështjes sonë Kombëtare



DAUT LUBOJA

Kryetari i LEK-ut, Daut Luboja së pari i përshendeti të pranishmit, e lexoi biografin e të ndjerit dhe në fund tha se:

Burrat e mëdhenj nuk vdesin kurr, ata jetojn së bashku me veprën e tyre.



QELË NEZIRI

Zt.Qel Neziri –Aktivist i dalluar dhe ish Kryetar i tret i partis së IRDK-së, dega në Zvicër



Zt.Neziri, komentoj secilën foto një nga një dhe Video materialin nga arkiva e LEK-ut, që e kishte përgatit Kryetari i LEK-ut:Daut Luboja



QERIM ABAZI

Zt. QERIM ABAZI - Veteran dhe Aktivist i pa lodhur i çështjes sonë Kombëtare.

Në fillim e ngushëlloi familjen e të ndjerit që ishte prezent dhe tha se **për të folur sot për të ndjerin Ibish Bajrami, gjegjesisht veprimtarin e tij, na duhet shumë kohë. Por unë si bashkëpunor i tij - një dekadë me radhë, do të mundohem ti ceku vetëm disa pika te shkurtëra të historisë sonë të viteve 1990-1999, sepse mekat i madh është që aktivitetin e tij patriotike të kesaj periode kushtuar popullit tonë Egjiptian të Kosovës t'ia humbim.**

Për të ndjerin, të pranishmëve iu solli këto kujtime:

Unë si veprimtar i kësaj Levizje do të mundohem të ju veçoj disa kujtime që i kisha me të ndjerin :

Më kujtohet viteve 90-ta, në njerën nga mbledhjet e Kryesise sonë ku i ndjeri Ibish Bajrami erdhi ne banesen time (e cila ishte seli e Shoqates), i shoqëruar nga Zt. Elez Krasniqi dhe nga i ndjeri Axha Arif Gara.

Zt. Elez Krasniqi e prezentoj të ndjerin si biznesmen te dalluar dhe tha se tani e tutje Ibishi është bashkëpunor i yni. I ndjeri me aktivitetin e tij te dalluar tregoi sukses në punë, kështu që arriti besimin që të zgjidhet Kryetar i Deges së Shoqatës Egjiptiane të Kosovës me seli në Pejë.

Vlenë për tu cekur takimi që patem me zt. Hysni Zemoski nga Ohri i Maqedonisë i cili u mbajt ne oden e Basri Peqanit në Fushë Kosovë ku morrën pjesë 150 pjesarë të komunitetit tonë. Ndër të tjerat më kujtohet kur Ibishi me disa shoke iu drejtuan Hysniut me fjalet,

Ne shumica nga Peja jemi anëtar të LDK-së, dhe a mundemi ne si anëtar të kesaj Partie të veprojm dhe punojm për identitetin tonë Egjiptian ?

Zt. Zemovski ju përgjegj:

Nuk ka problem zotëri, punoni dhe merruni me politik ashtu siç dëshironi dhe siç ju konvenon, por vetëm se ju duhet të deklaroheni në ato parti se ju i takoni Kombit Egjiptian.

Të gjithë të pranishmit kishin fjalë të mira për Ibish Bajramin, jo vetëm që ishte njeri i gjatë me mustaqe edhe shumë i pashëm por ishte trim dhe kishte vizion për Identitetin Egjiptian, ku edhe Zt. Zemoski në takimet tona të mëvonshme gjithëherë e cekte Ibishin se prej tij do te kemi suksese.

I ndjeri ishte i palodhur në punë, kështu që së bashku me të ndjerin Axhen Arif Gara, të ndjerin Mujë Qakollin, zt. Zymer Krasniqin dhe zt. Elez Krasniqin, ishte në mesin e popullit nëpër fshatra të Dugagjinit, ku arriti ti formoi disa Nëndeg të Shoqates duke shperndarë me mija libreza me identifikim Egjiptian.

Gjatë kesaj periode i ndjeri përpiquej që të ngreh në nivel të çmuar e të merituar identitein Egjiptian. Të gjitha këto përpjekje të tija dhe të shokve të tij u realizuan në Shtator te vitit 1998, kur për herë te parë në histori u pranua identiteti Egjiptian si minoritet me të gjitha të drejtat e barabarta me minoritetet tjera në Kosovë.

Ibish Bajrami patë zemër dhe trimëri. Kështu që nga të gjithë antarët e Kryesisë sonë, i ndjeri vazhdoi patriotizmin e tij dhe në kohrat më të vështira tuboi shokë për të vazhduar aktivitetin kombëtar duke iu përshtatur rrethanave kohore.

Në kohën e pasluftes, krahas furtunave të ndryshme gjithmon ngriti zerin kundër padrejtsive dhe etiketimeve të ndryshme që i bëheshin popullatës Egjiptiane. Në njërën nga gazetate shqipe lexova një artikull ku i ndjeri kishte ngrit zërin duke bere bum të madh me fjalet se nxënësve Egjiptian iu mohohet identitei i tyre dhe arsimitaret pa i pytur i regjistrojn si shqiptarë.

Nuk kaloi kohë e gjate dhe i ndjeri u emrua zv. minister për kthim e pastaj vazhdoi edhe me funksione tjera.

Ai punoi në forma të ndryshme, kaloi furtuna të llojllojshme dhe së bashku me shokë ia arriti qëllimin që identiteti Egjiptian të pranohet edhe në realitetin e ri Kosovar.

Pra i ndjeri ishte trim i së vërtetes i cili gjithmonë do të jeton në kujtesen tonë sepse la vepra të shumta patriotike kushtuar popullit tonë Egjiptian.

Edhe që ndrroi jetë, të ndjerin veprat e bëjnë të gjallë.

Inshallaha Allahu e shperblen me xhenet, e familjes se tij sabrin ia shton dhe dhimbjet ia lehtëson. Lavdi i qofte.



BAJRAM IMERAJ



Zt. Bajram Imeraj -Aktivist i dalluar dhe ish Kryetar i LEK-ut

Zt. Bajram Imeraj pas fjalës përshendetëse tha:

Unë nuk isha për të shok apo mik i tij por unë isha vëllau i tij.

Ne të dy qysh në kohërat e vështira e kemi ngrit zërin për qështjen e Kombit.

Ibishi ishte edhe këshilltar i mirë, shpesh më thoshte se ne duhet patjetër ti aktivizojm edhe disa Intelektual kështu që më vonë kontribuam në formimin e Partis Politike të IRDK-së.

Isha edhe tani në momentet e fundit pranë tij ku sëmundja e mundoi shumë dhe nuk u ndal së foluri për qështjen tonë Kombëtare e kritikova dhe i thash se ne te dytë jemi shëndet lig dhe kujdesu tani për shëndetin, ai më tha: **JO JO, EDHE DIT EDHE NAT NUK DO TË NDALEM KURR , DERI NË FRYMEN E FUNDIT.**

Zt. Bajram Imeraj ndër të tjera tha:

Unë nga emocionet që i kam tani nuk mund të flas më tepër por dua ta falenderoi edhe Kryesinë e Komunës së Pejes që edhe ata e organizuan një tubim Komemorativ ku i kan bër nder të ndjerit, familjes së tij dhe gjithë familjeve tona Egjiptase.

Lavdi i goft dhe unë e di se ai nuk ka vdek, por ai do të jetoj gjithmon në zemrat tona.





MILAZIM ALIJAJ

Zt.Milazim Alijaj - Kryetar i Shoqatës Kleopatra nga Gjermania ndër tjera tha:

Të nderuar motra dhe vllazër, më lejoni që në emrin tim personal, në emër të Kryesis dhe anëtarëve të Shoqatës tonë të ju shprehim Ngushëllimet tona me të sinçerta familjes të ndjerit Ibish Bajramit në Kosovë , diaspor dhe veçanarisht vajzës së tij e cila gjendet ketu prezent në mesin tonë, po ashtu edhe kolegëve të cilët filluan punën me të në vitet 90-ta, i cili njëri ndër ta është edhe këtu prezent Zt.Qerim Abazi si dhe ish-Kryesis së IRDK-së, ketu në Zvicër të cilët me të vërtet kan bashkëpunuar, një bashkëpunim të mirëfillt dhe të pa mohueshëm me të ndjerin Ibish Bajramin.

Humbja apo ndarja fizike e Ibish Bajramit është një humbje e madhe në të gjithë komunitetin tonë që gjindet në Europ, Ballkan e posçërisht në Kosovë, ku i ndjeri Ibish Bajrami dha një kontribut të madhë e të paharrueshëm të lëvizjes sonë Kombëtare duke filluar që nga vitet e 90-ta.

Qëllimi kryesor i asaj kohe dhe ideja e të ndjerit Ibish Bajrami ishte që të ngritet vetëdija e popullatës tonë që njëher e pëgjithmonë ta dijm vehtveten se kush jemi.

I ndjeri Ibishi ishte një strateg i madh, ku gjithmon në mendje e kishte popullin e vet e posaqërisht edhe në vitin 1999 nuk i mungonte guximi dhe mbrojti popullaten e vet në Kosovë, në kushtet më të vështira ku ishte në rrezik ekzistenca e popullatës tonë, dhe pas lufte nuk u ndal së punuari dhe gjithë aktivitetin dhe energjin e dha në të mir të komunitetit tonë, u mundua dhe arriti sukses që ta integroi komunitetit tonë sa më mirë në shoqërin e re Kosovare, andaj sot kemi përfaqësues në të gjitha Institucionet në kosovë, duke filluar nga Parlamenti e deri te ato të shoqëris civile.

Për jetën dhe veprën e të ndjerit Ibish Bajrami më së miri do të flet historia e popullit tanë , ku në këtë histori besoi që me shkronja të arta do të shkruhet edhe emri i Ibish Bajramit.

Vepra e Ibish Bajramit sdo të vdes kurr, populli gjithëmon do ta ket në zemrër si patriot dhe njeri Kombëtar.

Lavdi i qoft.



HAKI LUBOJA – Zv.i financave në LEK

Haki Luboja i shprehu ngushëllime familjes të ndjerit dhe bashkëpunorëve të tij më pastaj tha se do ta veçoj një kujtim ketu në Zvicër ku në shtëpinë e Bajram K. ishim së bashku mysafir dhe po ashtu ishin të ftuar shumë të tjerë, si një njeri me një moshë më të re unë isha i ulur në atë odë shumë të madhe, diku pak më larg ku më mahniti me bisedën e tij dhe mu duk vehtëvetja sikur u rrita përnjëherë në atë moment ku mysafirët të shumtë që ishin aty prezent, i bënin shumë pyetje të ndryshme kurse i ndjeri iu përgjigjete me një krenari me në burrëri të rradhë, me një gjuhë aqë të bukur dhe të pastër sa që të gjithëve na la shumë mbresa ku tha se **ne jemi Egjiptian dhe ne me modemos duhet të deklarohejmë ata që jemi e jo ata që nuk jemi.** Ishte hera e parë që e takova personalisht dhe që nga ai moment u ndjeva shumë i fort në zemër sepse më herët kam menduar se vetëm unë e kam atë ndjenjë kombëtare dhe të gjithë të tjerët që ishin prezent nga ai çast e muarën një kahje tjetër pozitive së menduari dhe dua të them në fund se i ndjeri në atë odë të Bajram Kikës e dha një kontribut të jashtëzakonshëm dhe siç e dim ne të gjithë se nga ka shkuar ka lënë mbresa tek populli Egjiptian dhe i ndjeri na tregoi se ne egzistojmë dhe e kemi një prejardhje prej nga kemi ardhur **andaj ne duhet të punojmë në këtë drejtim dhe ta ndjekim rrugën e tij për një ardhmëri më të mirë.**



ARBRESHA BAJRAMI

Z. Arbresha Bajrami (Vajza e të ndjerit) e falenderoi Kryesin e LEK-ut, për këtë organizim dhe përsëriti duke thënë se ju falenderoi sikur vllazër. **Kur po ju shof të gjithëve këtu, po e kam më lehtë. Po e shof se Babi im paska pas shumë vllazër, paska pas shumë koleg, dhe paska pas me kënd të punoj, edhe unë po ju lus që të vazhdoni të punoni për të ardhmen, që edhe djali im ta din se kush jemi ne, e mos të humbim.**

Mbas vdekjes së babait tim shkova në Kosovë dhe e pyeta mamën se a ka pas babi ndonjë dëshirë opo amanet?, dhe ajo mu përgjigj se **dëshira e tij e fundit ishte që rinia e jonë të shkollohet.** Edhe unë jam e vetëdijshme se te babi gjithmonë prioritet ishte shkollimi dhe puna.

Edhe njëherë në emër timin personal, në emër të mamit dhe në emër të familjes Bajrami ju falenderoi për përkrahjen e juve, për këtë ceremoni madhështore dhe për të gjitha që keni bërë për babin tim.



LUAN BAJRAMI

Zt. Luan Bajrami (Pjesëtar i Familjes Bajrami) e falenderoi Kryesinë e Lekut për këtë organizim kushtuar xhaxhait të tij të ndjer dhe tha se unë kam shumë të flas për xhaxhain apo prindërin tim. Ai mua qysh si fëmij më ka përkrahur shumë, kam punu me të kur isha 7 vjeçar dhe kam qenë në klasen e parë kur kemi fillu në lokal, apo qajtore të punoj me të, më jepte shumë këshilla. Mbas një kohe edhe unë si ju të gjithë e lëshova vendlindjen dhe erdha në Gurbet dhe kur u martova e ftova në Dasmën time dhe ai më tha se nuk mundem të vij e ta lë popullin në këtë kriz tani ku më së shumti ka nevoj për mua.

Tani në kohën e fundit kur e kaploi sëmundja, pati shumë vizita të shumta nga popullata dhe ai kurr nuk u ndal së menduari për popullatën Egjiptase. Ndër vizitorët erdhi edhe Zt. Xhevdet Neziraj dhe i tha se po merakosem shumë sepse kam dëgjuar se në një shkollë në Gjakovë egziston një paralele e ndar e minoritetit tanë e të lutem shko dhe rregulloje këtë çështje mbasi unë nuk po mundem të shkoj. Vllazër unë nga emocionet nuk po mundem të flas më tepër por dua të ju them se u pa vepra e tij dhe besoi që ka kolegë të tij që këtë popull ta ndihmojnë me shkollim, me punë dhe me të gjitha drejtat që i meriton ky popull, dhe në fund edhe njëherë ju falenderoj për këtë Tubim Komemorativ.



VLLAZNIM SAKU-Sekretar aktual i LEK-ut

Vllaznim Saku Pas fjalës ngushëlluese i nformoi të pranishmit që leku në të ardhëmen për çdo vit në muajin qershor do të organizon Aktivitetet Rinore në emër të Ibish Bajramit.



SAMI RADI



Zt.Sami Radi – Aktivisti i shquar dhe ish Kryetar i par i IRDK-së, në Zvicër, pasi e përshendeti masën dhe shprehu ngushëllime për të ndjerin ai tha:

Këtu pak a shumë u thane Tërthorazi por unë tani dua të shtoj që :

Lëvizja Egjiptiane mbas lufte në Kosovë nuk do të ishte po mos të ishte i ndjeri Ibish Bajrami.

Kur them Lëvizja Egjiptiane e kam fjalën për: Shoqatën Shqiptaro-Egjiptiane, IRDK-në, Deputetët tanë, Zëvendësministrin, Kryetarët e Komunave, etj

Kur e them këtë nuk e them për rastin që ai nuk është në mesin tonë, por e them se në atë kohë, siç e din edhe bashkëpunëtorët e mi se është biseduar se ka qenë mundësia që ne mos të thirremi si Egjiptian dhe një ndër opsionet ishte që ne të thirremi ndoshta si Ashkali,

Këto hezitime janë paraqit në atë kohë duke menduar që të mos rrezikojm popullatën mbas lufte mbas deklartimit tonë Egjiptian dhe personat që e kanë studiuar këtë mundësi apo këtë alternativ janë mu ata aktivist të dalluar të asaj kohe dhe të kohës së tashme por i ndjeri Ibishi ishte ai cili ka thënë se ne do të quhemi Egjiptian dhe të vazhdojmë ata që jemi.

Mu për këtë edhe këtu siç u përmend nga shumica nga ju se Ibishi ishte Trim edhe unë them se Ibishi ishte trimi më i madhi nga të gjithë ne.

Po e përsëris edhe njëherë se Lëvizja Egjiptiane dhe Identiteti Egjiptian mbas lufte nuk do të ekzistonte në Kosovë, po mos të ishte Ibishi dhe ne që jemi sot këtu të pranishëm ndoshta do të pajtoheshim me termin Ashkali, pra dua të them se kjo meritë i takon Ibish Bajramit .

Jam edhe ndër ata që jam fjalos më së shumti me të ndjerin Ibishin për shumë çështje politike edhe këtë po e kuptoj pas vdekjes tij pasi në të e pasna pa (në mënyrë figurative) gozhdën në sharrë dhe e kam ditë se ai do të reagojë në çdo diskriminim.

Dhe tani sigurisht mund të them se *Ne nuk i duhemi më Ibishin por ai tani na duhet neve.*

F A L E N D E R I M

**Në emër timin dhe në emër të
anëtarëve të Kryesisë së LEK-ut,
në Zvicër, i falenderoj të gjithë
pjesëmarrësit e nderuar që mbushen
sallën pasi nëpërmjet të kësaj pranie
u nderua vepra dhe karakteri i ndershëm
i të ndjerit Ibish Bajrami i cili tër jetën ia
kushtoj popullit të vet me një fuqi të
pamposhtur dhe heroike**

Kryetari i LEK-ut:

D. Luboja



E punoi: Daut Luboja

